

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe  
siguria  
(Zgjidhjet)**

**P10**

Data 06/10/2018

## Detyra 1

(a) Udhëzimet për ngjarjet pasuese janë dhënë në SNA 560 *Ngjarjet Pasuese*.

### Kërkohet:

Shpjegoni përgjegjësinë e auditorit lidhur me ngjarjet pasuese.

(5 pikë)

(a) Ju jeni menaxheri i auditimit përgjegjës në auditimin e Burreci Shpk, një kompani që dizajnon dhe prodhon pjesë elektronike. Auditimi i pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017 është afër përfundimit dhe ju jeni duke i rishikuar letrat e punës të seksionit të hipotezës së vijimësisë në dosjen e auditimit. Pasqyrat financiare draft paraqesin një humbje prej €500,000 (2016 – fitim prej €760,000) dhe pasuri totale prej €13.8 milion (2016 – €14.4 milion).

Seniori i auditimit ka shënuar informatat në vijim për tu adresuar nga ju:

‘I kam kryer procedurat analitike në pasqyrat financiare të fundvitit. Koeficienti qarkullues është 0.8 (2016 – 1.2), koeficienti i shpejtësisë është 0.5 (2016 – 1.6). Në pasqyrat e fundit menaxheriale paraqitet se këta koeficient janë përkeqësuar që nga fundi i vitit dhe kompania tani ka para të gatshme vetëm €25,000. Burreci Shpk ka një saldo të kredisë nga banka në vlerë prej €80,000 me disa kushte të cilat theksojnë se nëse koeficienti qarkullues bie nën 0.75, kredia duhet të kthehet menjëherë.’

Ju po ashtu jeni në dijeni se njëri nga produktet, Telecom, që është shitur më së miri, është bërë teknikisht vjetëruar gjatë vitit 2017 pasi që konsumatorët tani preferojnë pajisje që janë më miqësore ndaj mjedisit. Historikisht produkti Telecom ka gjeneruar 45% të të hyrave të kompanisë. Si përgjigje ndaj kërkesave të konsumatorëve kompania ka investuar €1.3 milion në dizajnin e produktit të ri ‘Ecofon’ i cili pritet të lansohet në shkurt të vitit 2014 dhe i cili pritet të reklamohet si produkt miqësor ndaj mjedisit.

Është përgatitur një parashikim i rrjedhës së parasë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018, i cili duke u bazuar në supozime të caktuara parashikon se saldo e parasë së gatshme do të rritet në €220,000 deri në fund të periudhës së parashikimit.

Supozimet përfshijnë:

1. Lansimi i suksesshëm i produktit ‘Gjelbërosi’,
2. Shitja e fabrikës dhe makinerive që janë përdorur në prodhimin e produktit ‘Telecom’. Kjo shitje parashihet të ndodhë në qershor 2018 dhe do të gjenerojë para në vlerë prej €50,000.
3. Zvogëlimi në kosto të pagave prej 15%, që shkaktohet nga zvogëlimi i fuqisë punëtore të fabrikës që prodhonte ‘Telecom’, dhe
4. Pranimi i një granti qeveritar prej €30,000 që ju ofrohet kompanive që promovojnë produkte ekologjike. Kjo parashihet të ndodhë në korrik 2018.

### Kërkohet:

(i) Identifikoni dhe shpjegoni çështjet të cilat hedhin dyshim mbi statusin e hipotezës së vijimësisë së kompanisë Burreci. (6 pikë)

(ii) Shpjegoni dëshmitë e auditimit që pritet të gjeni në dosjen e auditimit lidhur me parashikimin e parasë së gatshme. (8 pikë)

(b) Pasi që keni përfunduar rishikimin e dosjeve të auditimit, ju keni arritur në përfundim se përdorimi i hipotezës së vijimësisë është i përshtatshëm por ekziston një dyshim domethënës lidhur me aftësinë e kompanisë të vijojë sipas kësaj hipoteze. Ju e keni këshilluar komitetin e auditimit të kompanisë se nevojitet të përfshihet një shënim në pasqyra financiare për të përshkruar dyshimin domethënës për hipotezën e vijimësisë. Komiteti i auditimit është duke ngurruar të përfshijë një shënim të detajuar në pasqyrat financiare për shkak të frikës se shënimi do të tregojë për problemet e kompanisë dhe do të shkaktojë vështirësi të mëtejshme financiare, por janë pajtuar se do të përfshihet një shënim i shkurtër.

**Kërkohe:**

Sa i përket shënimit lidhur me hipotezën e vijimësisë që duhet të përfshihet në pasqyrat e kompanisë, diskutoni ndikimin në raport të auditimit dhe shpjegoni veprimet e mëtutjeshme të auditorit. (6 pikë)

[Total: 25 Pikë]

(a)

Ngjarjet pasuese definone si ngjarje që ndodhin në mes të datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të auditimit, dhe po ashtu faktet që janë zbuluar pas datës së raportit të auditimit.

SNA 560 *Ngjarjet pasuese* bëjnë dallimin në mes të përgjegjësive të auditorit lidhur me ngjarjet pasuese varësisht nga koha kur ndodhë një ngjarje pasuese.

Ngjarjet që ndodhin deri në datën e raportit të auditorit.

Auditori ka detyrë aktive për të kryer procedura të dizajnuara për të identifikuar dhe përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të gjitha ngjarjet deri në datën e raportit të auditorit të cilat ngjarje mund të kërkojnë korrigjim ose shpalesje në PF. Këto procedura duhet të kryhen sa më afër të jetë e mundshme datës së raportit të auditorit, dhe përveç kësaj duhet të kërkojnë përfaqësime nga menaxhmenti.

Procedurat mund të përfshijnë rishikimin e procedurave të menaxhmentit për të siguruar se ngjarjet pasuese janë identifikuar, leximi i procesverbaleve të takimeve të bordit, rishikimi i pasqyrave financiare të ndërmjetme, bisedat e duhura menaxhmentin.

Kur një ngjarje material pasuese është zbuluar, auditorit duhet të konsiderojë nëse menaxhmenti ka trajtuar si duhet dhe shpalesur si duhet në PF në pajtueshmëri me SNK 10 *Ngjarjet pas datës së raportimit*.

Faktet e zbuluara pas datës së raportit të auditorit por para datës së publikimit të PF.

Auditori nuk ka ndonjë përgjegjësi të kryej procedura ose ti parashtrijë pyetje menaxhmentit sa i përket pasqyrave financiare ose ngjarjeve pasuese pas datës së raportit të auditimit. Në këtë periudhë, është përgjegjësi e menaxhmentit të informojë auditorin për faktet të cilat mund të ndikojnë në PF.

Kur auditori është në dijeni për faktet të cilat mund të ndikojnë materialisht PF, çështja duhet të diskutohet me menaxhmentin. Nëse PF janë ndryshura në mënyrë të duhur, atëherë duhet të jepet një opinion i ri i auditimit, dhe procedurat që kanë të bëjnë me ngjarjet pasuese duhet të shtrihen deri në datën e raportit të ri. Nëse menaxhmenti nuk i ndryshon PF për të reflektuar ngjarjen pasuese, në rrethana kur auditori beson se duhet të ndryshohet, duhet të jepet opinion me rezervë ose i kundërt.

Faktet e zbuluara pasi që pasqyrat financiare janë publikuar.

Pas publikimi të pasqyrave financiare, auditori nuk ka obligim të parashtrijë pyetje lidhur me PF. Mirëpo, nëse auditori është në dijeni për ndonjë fakt që ka ekzistuar në datën e raportit të auditimit, që po të dihej në atë kohë do të shkaktonte modifikimin e raportit të auditorit. Në këtë rast, çështja duhet të diskutohet me menaxhmentin. Kjo mund të rezultojë me korrigjim të pasqyrave financiare, dhe në këtë rast auditori do të lëshonte raport të ri të auditimit për PF të korrigjuara. Ky raport do të përfshijë një paragraf të theksimit të çështjes që i referohet shënimit në PF në të cilin paraqiten arsyet e korrigjimit të PF. Nëse menaxhmenti refuzon të korrigjoj PF, auditori duhet të marrë këshilla ligjore me qëllim të përpjekjes për të parandaluar mbështetjen e mëtutjeshme të shfrytëzuesve të PF në raportin e auditimit.

(b) Hipoteza e vijimësisë

## **Performanca**

Rënia nga fitimi i mirë në një humbje prej €0.5 milion. Kjo duket se është rezultat nga dalja jashtë mode e produktit kryesor dhe humbja e 45% të të hyrave.

Duket se profitabiliteti do të bie edhe më shumë në vitet e ardhshme si efekt i moshtijes së produktit kryesor.

Edhe pse kompania ka zëvendësimin, çfardo produkti i ri do të merr kohë për të fituar pjesën e duhur të tregur dhe nu ka shumë mundësi që ky trend i rënies do të kthehet në të kundërtën shumë shpejtë.

## **Likuiditeti**

Përkeqësimi i koeficientëve të qarkullimit dhe të shpejtësisë trgojnë për një rënie të vazhdueshme të likuiditetit. Me detyrimet qarkulluese që janë më të mëdha se pasuritë qarkulluese kompania nuk do të ketë mundësi të paguaj borxhet kur ju vjen koha. Nëse nuk paguhen furnitorët atëherë ata mund të kufizojnë furnizimin.

Përveç kësaj, nëse ka stoqe të produktit të vjetër atëherë duhet të njihen humbje nga dëmtimet dhe kështu koeficientët do të zbresin edhe më shumë.

## **Pozita e parasë**

Saldoja e parasë së gatshme të kompanisë prej €25,000 është shumë e ulët që përfaqëson vetëm 0.2% të pasurive totale. Ka pak mundësi që kompania të mbijetojë me aq pak para. Nuk dihet nëse kompania ka mbiterheqje që mund të ndihmonte të mbijetonte për së paku edhe disa kohë.

## **Kushtet e kredisë**

Pasi që koeficientët e qarkullimit dhe shpejtësisë kanë rënë në krahasim me vitin e kaluar, ka mundësi që kushtet e kredisë tashmë janë shkelur. Nëse tërhiqet kredia nga banka, paraja ekzistuese nuk do të jetë e mjaftueshmer për të paguar atë.

Kompania mund të duhet të shes pasuri tjera për të paguar kredinë.

## **Lansimi i produktit të ri**

Mungesa e kapitalit qarkullues të kompanisë do të bënte të vështirë zhvillimin e produktit të rid he lansimin e tij, që do të ishte një rrezik i madh për hiptezën e vijimësisë.

## **Dëshimitë**

- Përputhja e parasë në fillim ne pasqyrat financiare të audituara për të siguruar saktësinë e shifrave
- Rillogaritja e saktësisë matematikore të parashikimit të parasë
- Rishikimi i rezultateve të hulumtimit të tregut për produktin e ri ekologjik, për të siguruar se supozimet lidhur me lansimin e suksesshëm janë të përshtatshme
- Diskutimi i progresit të bërë në zhvillimin e produktit ekologjik me ekspertin teknik, për të vlerësuar mundësinë e lansimit të suksesshëm
- Rishikimi i korrespondencave me konsumatorët për të vlerësuar interesin e tyre për të blerë dhe porositur porduktin e ri
- Rishikimi i dokumentacionit të shitjes lidhur me shitjen e pajisjeve për të konfirmuar se €50,000 janë të arritshme
- Inspektimi fizik i fabrikës dhe pajisjeve që do të shiten për të vlerësuar kushtet dhe mundësinë e shitjes

- Rishikimi i paralajmërimeve të bëra për largimin nga puna për të konfirmuar numrin e punonjësve që do të ndikohen
- Testimi përmes mostrës së punonjësve që do të largohen nga puna, duke përputhur shumën që do të paguhet me të dhënat nga burimet njerëzore, për të siguruar saktësinë e parashikimit
- Rishikimi i aplikimit të bërë te qeveria për të konfirmuar shumën e grantit. Konfirmimi i korrespondencave nga qeveria për pranimin e €30,000.
- Pajtueshmëri e rrjedhës së parasë nëse është konsistente me fitimin dhe parashikimet tjera të përgatitura nga menaxhmenti
- Konfirmimi se supozimet e bëra në përgatitjen e parashikimit të parasë janë konsistente me njohurinë e auditorit për biznesin dhe qëllimet e menaxhmentit
- Krahasimi i parashikimit të parasë së gatshme për periudhën e ardhshme me pasqyrat menaxheriale, për të siguruar saktësinë e parashikimit
- Procedurat analitike të përfshira në parashikimin e rrjedhës së parasë, psh, kategoritë e shpenzimeve dhe hulumtimi i zërave që mund të jenë shmangur

#### (c) Ndikimi mbi raportin e auditimit

SNK 1 Prezentimi i pasqyrave financiare kërkon shpallje për situatat kur ka dyshime domethënëse mbi hipoteën e vijimësisë. Një shënim i shkurtër ka gjasë të jetë i pamjaftueshëm pasi që shënimi duhet të përshkruaj arsyet për dyshimin së bashku me planet e menaxhmentit për të dalur nga kriza.

#### **Shpallja e mjaftueshme**

Në këtë rast është në pajtueshmëri me SNK 1 prandaj pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali material. Në këtë rast auditori do të përfshij një paragraph për theksimin e çështjes por opinion nuk do të ndryshojë.

Auditori duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen lidhur me modifikimin e raportit të auditorit.

#### **Shpallja e pamjaftueshme**

Në këtë rast ka anomali material sa i përket SNK 1. Pyetja për auditorin është nëse anomalia është vetëm materiale apo përhapëse. Në rastin e parë auditori duhet të jep opinionin me rezervë ndërsa në rastin e dytë të jep opinion kundër.

Në të dy rastet duhet të përfshihet një paragraph i bazës së opinionit me rezervë/kundër dhe dot ë përshkruaj arsyet e modifikimit të opinionit. Ky paragraph vendoset para paragrafit të opinionit.

Auditori duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen lidhur me modifikimin e raportit të auditorit.

## Detyra 2

Ju jeni menaxher i auditimit në firmën Kiko Audit. Ju jeni përgjegjës për auditimin e Gold Shpk, një kompani kryesore e furnizimit me gaz për biznese dhe shtëpi në tërë vendin.

Puna e auditimit në terren për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017 është afër përfundimit.

Pasqyrat financiare draft paraqesin fitim para tatimit prej €130 milion (2016 – €110 milion), edhe pasuri totale prej €1,900 milion (2016 – €1,878 milion).

Ju jeni duke e rishikuar dosjen e auditimit lidhur me çështjet në vijim:

### (a) Provizioni për çmontim

Në pasqyrat financiare është njohur një provizion prej €430 milion (2016 – €488 milion) si detyrim afatgjatë. Ky provizion ka të bëjë me koston e çmontimit të pajisjeve prodhuese dhe të depozitimit të gazit kur janë afër përfundimit të jetës së përdorimit të tyre. Kostoja e vlerësuar e çmontimit është bazuar në nivelet e çmimeve dhe teknologjisë në datën e raportimit dhe është skontuar në vlerën e tanishme duke përdorur normën prej 8% (2016 – 6%). Koha e pagesës së çmontimit varet nga jeta e përdorimit të pajisjeve por pritët të ndodhë në vitin 2046, shumica e koston së çmontimit do të ndodhë në mes të viteve 2025 and 2040.

Shënimi i politikave të kontabilitetit për këtë çështje përshkruan metodologjinë e përdorur nga menaxhmenti në përcaktimin e vlerës së provizionit për çmontim dhe thekson se kjo është një fushë ku përdoret gjykim kritik kontabël përfshirë fushat kryesore lidhur me pasigurinë e vlerësimeve kontabël. Vlerësimi i këtij provizioni është bërë nga menaxhmenti. Në vitet e mëparshme kompania kishte angazhuar një ekspert për të ofruar këto vlerësime, por pasi që ai ekspert ishte i shtrenjtë, menaxhmenti kishte vendosur që të bënte vet vlerësimin e provizionit për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017. (10 pikë)

### (b) Zhvlerësimi

Pasqyra e pozicionit financiar draft përfshinë impiantet dhe pajisjet, që nuk kanë të bëjnë me prodhimin ose depozitimin e gazit, me vlerë bartëse prej €65 milion. Ka pasur një ndryshim në teknikën e vlerësimit që është përdorur në përcaktimin e zhvlerësimit për këto pasuri gjatë vitit. Më parë zhvlerësimi është llogaritur në bazën drejtëvizore për 10 vite të përdorimit, por nga 1 dhjetor 2016, jeta e përdorimit është ndryshuar në 15 vite. Drejtori financiar i ka shpjeguar ekipit të auditimit se është bërë rishikimi i jetës së përdorimit mbi bazën se pasuritë janë duke u përdorur më gjatë se sa është parashikuar në fillim.

Ndryshimi në politikën e zhvlerësimit është trajtuar si korrigjim i vitit të kaluar, që ka rezultuar me një rritje prej €20 milion në pasuritë joqarkulluese dhe në fitimet e mbajtura. Shpenzimi i zhvlerësimit në pasqyrën e të ardhurave për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017 është €12 milion (2016 – €15 milion). (8 pikë)

### (c) Llogaritë e arkëtueshme

Pasqyra e pozicionit financiar draft përfshinë gjithsej €450 milion (2016 – €390 milion) llogari të arkëtueshme.

Ekipi i auditimit ka kryer procedura analitike si procedura të pavarura me rezultatet në vijim:

<b>Periudha e mbledhjes së të arketueshmeve:</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Konsumatorët rezidencial	65 ditë	58 ditë
Konsumatorët - biznese	50 ditë	55 ditë

Shënimet e pasqyrave financiare përmbajnë informatat në vijim lidhur me llogaritë e arkëtueshme:

<b>Llogaritë e arkëtueshme:</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
	<b>(€ milion)</b>	<b>(€ milion)</b>
Konsumatorët rezidencial	158	145
Konsumatorët - biznese	356	289
<i>Minus: lejimi për borxhe të këqija</i>	<i>(64)</i>	<i>(44)</i>
Llogaritë e arkëtueshme neto	450	390

Të arkëtueshmet nga konsumatorët biznesor në përgjithësi rishikohen për dëmtim në baza individuale në rastet kur konsumatori e ndryshon furnitorin e gazit, pra duke e ndërprerë marrëdhënien me kompaninë. Të arkëtueshmet nga konsumatorët rezidencial rishikohen për dëmtim kur vonesa për pagesë i kalon 90 ditë ose kur konsumatorët kanë historik të pagesave me vonesë. Që nga hyrja në fuqi e një sistemi të ri të faturimit në mars 2017, menaxhmenti ka ushtruar gjykime shtesë për nivelin e duhur të lejimit për borxhe të këqija.  
(7 pikë)

**Kërkohet:**

Komentoni mbi çështjet që duhet të konsiderohen dhe shpjegoni dëshmitë e auditimit që prisni ti gjeni në dosjen e auditimit lidhur me çështjet e mësipërme.  
NUK kërkohet të shpjegoni ndikimin e mundshëm të këtyre çështjeve në opinionin e auditimit.

[Total: 25 Pikë]

## Përgjigja

### (a) Provizionit i çmontimit

#### Çështjet

Provizioni është material pasi që është 22.6% e pasurive. Provizionit ka ndryshuar në vlerë nga viti në vit, duke u zvogëluar për €58 milion që paraqet një zvogëlim domethënës prej 11.9%. Sipas SNA 540 Auditimi i Vlerësimeve Kontabël përfshirë Vlerësimet e Kontabilitetit me Vlerën e Drejtë dhe Shpalosjet Përkatese, ekipi i auditimit duhet të testojë se si i ka bërë menaxhmenti vlerësimet dhe të dhënat që ka përdorur. Ekipi i auditimit duhet të testojë efektivitetin e kontrolleve relevante dhe të zhvillojë vlerësimet e tyre për të krahasuar ato me të menaxhmentit. Vlera e provizionit normalisht pritet të rritet pasi që data e çmontimit afrohet, prandaj ekipi i auditimit duhet të kuptojë në plotësi arsyet e zvogëlimit në provision. Mund të ketë arsyet të vlefshme si psh kosto e vlerësuar e çmontimit është zvogëluar ose data e çmontimit është më vonë.

SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente kërkon që shuma që është njohur si provision duhet të jetë vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të kërkuara për të paguar obligimin e tanishëm në datën e raportimit dhe provizionet maten me vlerën e tanishme. Në rastin e kompanisë, kur obligimi pritet të paguhet pas shumë vitesh, metoda e përdorur për të skontuar detyrimin në vlerën e tanishme do të ketë ndikim domethënës në matjen e provizionit. Për shembull, përdorimi i 8% për të përcaktuar faktorin skontues në vend të 6% dot ëzvogëlonte vlerën e provizionit, prandaj ndryshimi i normës së interesit duhet të konsidërohet me kujdes nga ekipi i auditimit.

Duhet të merren parasysh regjistrimet kontabël të cilat janë bërë për të ndryshuar vlerën e provizionit. Kur në fillim është njohur vlera e provizionit për çmontim nuk ka pasur ndikim në fitim pasi që kosto është kapitalizuar si pjesë e pasurive përkatëse joqarkulluese. Korrigjimet e mëvonshme në vlerën e provizionit mund të ishin ngarkuar në fitim ose janë njohur si korrigjim i vlerës së pasurisë joqarkulluese, varësisht nga aryeja e korrigjimit. Puna e auditimit duhet të arrijë në përfundim lidhur me përshtatshmërinë se si n jë ndryshim prej €58 milion është njohur në pasqyrat financiare. Në veçanti, vlefshmëria e çfardo regjistrimi në anën kreditore në fitim duhet të analizohet në detaje pasi që kjo mund të jetë tregues për kontabilitet kreativ ose menaxhment të fitimeve.

Në vitet e mëparshme menaxhmenti kishte angazhuar ekspert për të ofruar vlerësime, por këtë vit vlerësimi është përgatitur nga vetë menaxhmenti. Në këtë rast kemi rrezik të rritur të gabimit dhe anësisë së menaxhmentit lidhur me teknikat e përdorura të vlerësimit. Ekipi i auditimit duhet ti qaset kësaj çështje me skepticizëm profesional dhe të vlerësojë nëse shpenzimi i ekspertit ishte arsyeja e vërtetë pse menaxhmenti ka bërë vlerësimin vetë.

#### Dëshmitë

- Një kopje e llogaritjes nga menaxhmenti të vlerës së provizionit prej €430 milion me të gjithë përbërësit dhe dokumentet.
- Shënimet nga takimet e menaxhmentit me arsyet e zvogëlimit në provision, përfshirë supozimet e menaxhmentit. Në veçanti, menaxhmenti duhet të ofroj arsyetim për ndryshimin e normës së interesit nga 6% në 8%.
- Kopjet e burimit të të dhënave të përdorura nga menaxhmenti në vlerësim, përfshirë informatat për pasuritë relevante dhe jëtën e tyre të përdorimit.
- Një krahasim të llogaritjes së provizionit të këtij viti me vitin e kaluar, duke konfirmuar konsistencën në qasje dhe në metodologjinë e përdorur.
- Kopjet e informatave përkatëse për koston e pritshme të çmontimit, vlerësimin e arsyeshmërisë nga ekipi i auditimit.
- Vlerësimi i të gjitha supozimeve kyçe, duke konsideruar konsistencën me njohurinë e auditorit për biznesin dhe përfundimin për vlefshmërinë e tyre.
- Një vlerësim të pavarur të përgatitur nga ekipi i auditimit dhe diksutimi i çfardo varianve në mes të vlerësimit të menaxhmentit.



- Nëse ekipi i auditimit nuk ka ekspertizën e nevojshme për këtë vlerësim, duhet të kërkohet vlerësim nga një ekspert i pavarur. Ky vlerësim i dokumentuar duhet të rishikohet nga ekipi i auditimit dhe të përfshihet në dosjen e auditimit.

#### **(b) Zhvlerësimi**

Impinantet dhe pajisjet janë njohur me vlerë prej €65 milion; kjo vlerë është materiae për pasqyrat financiare pasi që paraqet 3.4% të pasurive. Zhvlerësimi i njohur në pasqyrën e të ardhurave paraqet 9.2% të fitimit para tatimit, prandaj është poashtu material.

Janë dy çështje kryesore të konsiderohen lidhur trajtimin kontabël dhe zhvlerësimin.

E para, arsyeja e ndryshimit në vlerësimin për jetën e përdorimit duhet të justifikohet në mënyrë të përshtatshme. Nuk ka asgjë të keqe në korigjimin e jetëgjatësisë së pasurive joqarkulluese pasi që ajo duhet të rishikohet çdo vit ashtu siç kërkon SNK 16.

Megjithatë, korigjimi i jetëgjatësisë duket se është mjaft domethënës, duke rezultuar me një zvogëlim prej €3 milion në shpenzimin vjetor të zhvlerësimit, që është ekuivalent me zvogëlim prej 20% të shpenzimeve të njohura në vitin e mëparshëm duke e rritur kështu fitimin para tatimit me 2.3%. Ka gjasë që menaxhmenti ta ketë ndryshuar jetëgjatësinë me qëllim të rrisë fitimi, prandaj ekipi i auditimit duhet të jetë skeptik lidhur me arsyet e ndryshimit të jetëgjatësisë.

E dyta, ndryshimi në vlerësim është trajtuar si duhet në kontabilitet. Sipas SNK 16, kur ka një ndryshim në jetëgjatësinë e një pasurie, kjo duhet të njihet në të ardhmen si ndryshim në vlerësim sipas SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet. Në këtë rast kompania ka trajtuar gabimisht si korigjim i vitit të mëparshëm, që do të thotë se është trajtuar si gabim e jo si ndryshim në vlerësim kontabël.

Bazuar në informatat e ofruara, edhe pasuritë joqarkulluese edhe fitimet e mbajtura janë mbivlerësuar për €20 milion. Kjo paraqet 1.1% të pasurive totale dhe është në kufirin me materialitetin. Nëse qëllimi i këtyre korigjimeve është menaxhmenti i fitimeve me qëllim, atëherë ekipi i auditimit duhet të rivlerësojë rrezikun e auditimit dhe të përcaktojë një vlerë tjetër më të ulët të materialitetit. Më tutje, ky është zbatim i gabuar i një politike të kontabilitetit prandaj duhet të konsiderohet material për shkak të natyrës.

#### **Dëshmitë**

- Shënimet nga takimet e menaxhmentit ku është diskutuar trajtimi i gabuar në kontabilitet i ndryshimit në vlerësimin kontabël, së bashku me konfrimimin nga menaxhmenti se do të bëhet korigjimi në pasqyra financiare.

- Konfirmimi se vlera bartëse e impianteve dhe pajisjeve dhe fitimet e mbajtura janë korigjuar për të hequr €20 milion që është njohur gabimisht si korigjim i fitimit të vitit të kaluar.

- Përputhja e vlerës bartëse të pasurive me regjistrin e pasurive dhe verifikimi fizik i tyre për të verifikuar gjendjen e tyre.

- Dokumentet mbështetëse për zgjatjen e jetës së përdorimit, psh raportet e mirëmbajtjes dhe raportet nga inxhinierët.

- Një përfaqësim i shkruar nga menaxhmenti që shpjegon dhe arsyeton ndryshimet në jetëgjatësinë e pasurive.

#### **(c) Llogaritë e arkëtueshme**

Totali i LLA është materil për pasqyrat financiare, përfaqëson 23.7% të pasurive.

Procedurat analitike të kryera nga ekipi i auditimit zbulojnë një trend të pazakont duke paraqitur rritje në ditët e periudhës së mbledhjes së llogarive tëa rkëtueshme nga konsumatorët rezidencial nga 58 në 65 ditë, për derisa periudha e mbledhjes nga konsumatorët binzese është zvogëluar nga 55 në 50 ditë. Arsyet e një trendi të tillë jokonsistent duhet të hetohen në tërësi me menaxhmentin. Të arkëtueshmet neto janë rritur me 15.4%.

Ndryshimet në periudhën e mbledhjes së LLA mund të lidhen me implementimin e sistemit të ri të faturimit. Menaxhmenti duhet të konfirmojë nëse ky sistem është implementuar në të dy kategoritë e konsumatorëve.

Lejimi për borxhet e këqija është rritur në mënyre domethënëse me 45.5%. Lejimi është material për pasqyrat financiare pasi që përfaqëson 3.4% të pasurive ndërsa lëvizja në lejime përfaqëson 15.3% të fitimit. Shënimi në pasqyrat financiare tregon se implementimi i sistemit të ri të faturimit ka ndikuar në mënyrën e llogaritjes së lejimeve për borxhet e këqija dhe arsyet për këtë duhet të diskutohen me menaxhmentin.

Ekipi i auditimit duhet të dokumentoj dhe vlerësoj sistemin e ri, duke përdorur testet hap-pas-hapi dhe të konfirmojë njohurinë se si funksionon sistemi përfshirë kontrollet mbi atë sistem.

#### Dëshmitë

- Shënimet nga takimet e menaxhmentit mbi ndryshimin në periudhën e mbledhjes së LLA, përfshirë arsyet e menaxhmentit për rritjen e periudhës për konsumatorët rezidencial dhe zvogëlimin e periudhës për konsumatorët biznese.
- Një kopje e analizës së vjetërsisë së LLA duhet të rishikohet për ndryshimet domethënëse në vitin aktual.
- Dokumentimi i sistemit të faturimit për të konfirmuar njohurinë se si funksionon sistemi përfshirë kontrollet mbi atë sistem.
- Procedura analitike lidhur me lejimet për kreditë e këqija, psh ndarjet dhe lëvizjet e llogarise së lejimeve sipas grupeve të konsumatorëve.
- Shënimet nga diskutimet me menaxhmentin të cilat përfshijnë supozimet e përdorura nga menaxhmenti në përcaktimin e lejimeve dhe metodave të përdorura, psh si % e saldove të LLA, etj.

### Detyra 3

(a) Përkufizoni 'pastrimin e parasë' dhe përshkruani procedurat që janë specifike për pastrimin e parasë që duhet të konsiderohen para dhe gjatë pranimit të angazhimit për auditim të Balaj SHA.  
(5 pikë)

(b) Ju jeni senior i auditimit në firmën CoGo Audit. Ju jeni përgjegjës për rishikimin e kontrollit të cilësisë dhe çështjeve etike për klientët e ndryshëm të firmës tuaj. Gjatë punës tuaj keni identifikuar çështjet në vijim:

#### **Molla Shpk**

Molla Shpk aktualisht kualifikohet si kompani e vogël me një qarkullim prej €7.5 milion (2016 - €5.3 milion), dhe si e tillë nuk kërkohet të auditohet sipas ligjit. Deri së voni firma juaj ka ofruar një gamë të gjërë të shërbimeve jo-audituese për Molla Shpk përfshirë kontabilitetin, pagat, tatimet dhe këshillimet. Para një kohe kompania pranoi një ofertë për një financim domethënës për ti ndihmuar në rritje. Menaxhmenti i Molla Shpk ka plane ambicioze për rritje dhe besojnë se të hyrat do të dyfishohen brenda një viti dhe do të vazhdojnë të rriten me normë të ngjashme në pesë vitet e ardhshme. Në mënyrë që të sigurohet financimi, drejtorët kanë vendosur të auditojnë pasqyrat financiare dhe kanë kërkuar nëse CoGo mund të jetë auditori i tyre si dhe të vazhdojnë të ofrojnë shërbimet ekzistuese. Kjo do të përfshijë auditimin e pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017 sipas kërkesës së financuesit të ri.

#### **Dardha Shpk**

Kompania Dardha Shpk, një kompani për shitje me pakicë, ju ka kërkuar të ofroni shërbime të auditimit dhe të tatimit. Si përgjigje ju i keni shkruar auditorit të mëparshëm për ta pyetur nëse ka ndonjë çështje për të cilat ju duhet të jeni në dijeni dhe të cilat mund të ju parandalojnë të pranoni angazhimin e auditimit. Pavarësisht telefonatave të shumta, ju nuk keni arritur të merrni një përgjigje nga auditori i mëparshëm. Pas diskutimit me menaxhmentin keni kutpuar se Dardha Shpk është duke e paditur auditorin për shkak të dëmit në reputacion që i kishte shkaktuar kompanisë raporti i modifikuar i auditorit të mëparshëm, për të cilin raport drejtorët e Dardha Shpk konsideronin se ishte i papërshtatshëm. Arsyja për opinion të modifikuar ishte zbatimi i një trajtimi kontabël të cilin auditori i mëparshëm e konsideronte si të papërshtatshëm dhe anomali materiale.

#### **Kumbulla ShA**

Kumbulla ShA është klient i firmës tuaj, i listuar në bursë. Menaxherët e Kumbulla kanë kërkuar të kryeni vlerësimin e aksioneve të një klienti tjetër tuaj, Krimbi Shpk, me qëllim të blerjes së tërë aksioneve të kësaj kompanie. Krimbi Shpk nuk është e listuar dhe të gjitha aksionet zotërohen nga pronari Ali Krimbi.

#### **Kërkohet:**

Komentoni mbi çështjet etike dhe profesionale dhe rekomandoni çfarë veprimesh duhet të ndërmerren nga auditori në rastet e:

- Molla Shpk; (7 pikë)
- Dardha Shpk; (7 pikë)
- Kumbulla ShA. (6 pikë)

[Total: 25 Pikë]

## **Përgjigja**

**(a)** – Pastrimi i parasë është proces përmes të cilit kriminelët tentojnë të fshehin origjinën e vërtetë dhe pronësinë e parave të gjeneruara nga aktivitetet kriminale, duke i lejuar atyre të mbajnë kontrollin mbi ato para dhe në fund të ofrojnë një mbulësë legjitime për burimin e të hyrave. Qëllimi i pastrimit të parasë është thyhet lidhja në mes të parasë dhe krimit nga i cili ka rezultuar.

Procedurat përfshijnë:

– Identifikimi i klientit

- Përcaktimi i identitetit dhe aktivitetit të biznesit, psh duke përfshirë pasaportën, adresën, certifikatën e biznesit.
- Konsiderimi nëse aktiviteti komercial ka kuptim biznesor (pra nuk është vetëm 'fytyra' e një aktiviteti joligjor)
- Përcaktimi i listës së aksionarëve kryesor dhe drejtorëve.

– Njohja me klientin:

- Komunikimi para angazhimit për të shpjeguar pronarit dhe drejtorëve të tjerë për natyrë dhe arsyet e procedurave të pranimit të angazhimit.
- Praktikë më të mira rekomandojnë se letra e angazhimit duhet të përfshijë paragraf në të cilët përshkruhet përgjegjësia e auditorit lidhur me pastrimin e parasë.

## **(b) Molla Shpk**

Kërcënimi i vetërishikimit

Nëse firma e auditimit e pranon auditimin dhe vazhdon të ofroj shërbime tjera, kjo mund të krijoj kërcënim të vetërishikimit ndaj pavarësisë. Kjo është për shkak të faktit se të gjitha shërbimet tjera kanë ndikim në pasqyrat financiare, prandaj auditorët do të rishikonin punën e tyre.

Kodi i Etikës së IFAC nuk i ndalon firmat e auditimit të ofrojnë shërbime të kontabilitetit dhe tatimeve për klientët e palistuar në bursë por kërkon masa mbrojtëse të duhura për të zvogëluar rrezikun në nivel të pranueshëm. Auditorët duhet të konsiderojnë se në çfarë mase ju nevojitet të përdorin gjykime gjatë ofrimit të shërbimeve tjera pasi që mund të paraqitet rreziku i rolit menaxherial të auditorit në kompani. Për të shmangur rrezikun e përgjegjësisë menaxheriale firma e auditimit duhet të sigurojë se ka aftësitë e duhura dhe se puna mbikqyret dhe rishikohet. Nëse shërbimet tjera që i ofrohen klientit janë administrative dhe rutinore, atëherë kërcënimi mund të jetë minimal. Mirëpo nëse kompania ia bart auditorit ndonjë përgjegjësi menaxheriale atëherë kërcënimi vështirë se mund të zvogëlohet në nivel të pranueshëm.

Auditimi i pasqyrave financiare

Firma e auditimit tashmë ka përfshirje domethënëse në përgatitjen e pasqyrave financiare të klientit që do të thotë se ata kanë zbatuar gjykime domethënëse gjatë përgatitjes. Duke konsideruar këtë rrezik të shtuar, dhe duke supozuar se janë përdorur ekipe të ndryshme në përgatitje të PF dhe në auditim, do të ishte diçka e përshtatshme që të rishikohet puna e auditimit para nënshkrimit të raportit të auditimit.

Veprimet

Nëse firma e auditimit e pranon angazhimin për auditim, ata duhet të përdorin personel të ndryshëm në auditim dhe shërbime tjera. Kjo do të thotë se firma e auditimit duhet të sigurohet se ka personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për të kryer shërbimet.

Nëse firma e auditimit ka qenë përgjegjëse për çfardo vendimi menaxherial, ata menjëherë duhet të ndërpresin këtë praktikë nëse duan të pranojnë angazhimin për auditim.

Mirëpo, ka shumë mundësi që firma e auditimit duhet të pres një perudhë kohore para se të angazhohet në auditimin e pasqyrave financiare për të zvogëluar kërcënimin e vetërishikimit. Ky vendim duhet të komunikohet menaxhmentit të kompanisë.

**Dardha Shpk**

## Kërcënimi i vetërishikimit

Ofrimi i shërbimeve të tatimeve dhe auditimit krijon kërcënimin e vetërishikimit por pasi që kompania nuk është e listuar, firma e auditimit duhet të zvogëlojë këtë kërcënim përmes masave të përshtatshme të mbrojtjes. Mirëpo, çështja lidhur me auditorin e mëparshëm është shqetësuese dhe ndikon në vendimin për pranim ose jo të angazhimit.

### Procedurat e pranimit

SNA 220 Kontrolli i Cilësisë për një auditim të pasqyrave financiare kërkon që firma e auditimit të përftojë informata të mjaftueshme për të konsideruar një gamë të çështjeve para se një angazhim të pranohet. Njëra nga këto çështje është integriteti i menaxhmentit. Një procedurë e tillë përftohet duke komunikuar me auditorin e mëparshëm.

Nëse partneri i angazhimit nuk është i kënaqur se ka përftuar informata të mjaftueshme, atëherë angazhimi nuk duhet të pranohet.

### Opinionin e mëparshëm ishte i modifikuar

Duket se menaxhmenti i kompanisë ka pasur një mosmarrëveshje domethënëse me auditorin e mëparshëm lidhur me trajtimet kontabël. Kjo ngrit një numër të çështjeve tjera:

- Nëse menaxhmenti është duke zbatuar parime të gabuara kontabël dhe efekti i tyre është material për PF, kjo do të shkaktojë modifikim të opinionit edhe në të ardhmen. Nëse menaxhmenti nuk e pranon përgjegjësinë për të zbatuar si duhet parimet e kontabilitetit, atëherë parakushti për të pranuar auditimin sipas SNA 210 dakordimi i kushteve të angazhimeve për auditim nuk është përmbushur, prandaj angazhimi nuk duhet të pranohet.

- Ka dyshim për integritetin e menaxhmentit pasi që duket sa ata kanë mosmarrëveshje me auditorin, që konsiderohet ekspert në trajtimet kontabël dhe me kërkesat e kornizave të raportimit financiar. Kjo mund të tregojë për mosgatishmërinë e menaxhmentit të pranojë kërkesat e raportimit financiar ose përpjekje me qëllim që të paraqes pamje jo të drejtë përmes pasqyrave financiare. Në cilën do mënyrë, firma e auditimit nuk duhet të pranojë angazhimin.

- Vetë padia tregon qëndrimin e menaxhmentit se ata kanë të drejtë ndërsa auditori jo. Kjo mund të jetë indikacion se menaxhmenti nuk ka faj dhe auditori mund të ketë qenë neglizhent gjatë punës së tij, prandaj nuk ka arsye që firma e auditimit të refuzojë angazhimin.

### Veprimet

Firma e auditimit duhet të përpiqet të përftojë informata nga menaxhmenti lidhur me padinë. Është e qartë se për këtë nevojitet ekspertizë më e thellë për të vlerësuar nëse auditori i mëparshëm ishte neglizhent. Një mënyrë do të ishte kërkesa për të analizuar korrespondencat me juristët e kompanisë nëse ju lejohet.

Nëse jo, firma e auditimit mund të rishikojë çështjen kontabël dhe të vendosë se cili do të ishte trajtimi i duhur.

Në secilin rast nëse firma e auditimit pranon të angazhohet, së pari duhet të këshillojë juristët e saj lidhur me çështjet dhe vendimin e për pranim/mos pranim të bëjë dikush në nivel më të lartë në firmën e auditimit.

## Kumbulla ShA

### Konflikti i interesit

Kodi i Etikës e definon konfliktin e interesit si rast që paraqitet kur firma e auditimit i ofron shërbime dy ose më shumë klientëve interesi i të cilëve lidhur me çështjen është në konflikt. Në këtë rast interesat e Kumbullës dhe Krimbit do të jenë në konflikt pasi që Krimbi do të donte të shes aksionet me çmim më të lartë ndërsa Kumbulla të blente aksionet me çmim më të ulët. Ky fakt krijon kërcënim domethënës për objektivitetin e firmës së auditimit, pasi që shihen se veprojnë për interes të ndonjërit prej palëve në dëm të palës tjetër. Palët në këtë rast do të dyshonin në shkëlqimin e konfidencialitetit nga ana e auditorit pasi që informata që ka ose mund të ketë auditori janë shumë të vlefshme për secilën palë.

### Kërcënimi i vetërishikimit

Kryerja e shërbimeve të vlerësimit krijon kërcënim të vetërishikimit sepse firma e auditimit do të ketë ndikim domethënës mbi vlerësimin e kompanisë Krimbi të cilat do të përdoren për të konsoliduar PF të tyre në një grup të cilat do të auditoheshin nga firma e njëjtë e auditimit.

### Veprimet

Ka mundësi që të dy kërcënimet (konflikti i interesit dhe vetërishikimi) të zvogëloheshin në nivel të pranueshëm nëse përdoren ekipe të ndryshme për të kryer shërbime të ndryshme.

Kodi i Etikës thekson se firma e auditimit nuk duhet të ofrojë shërbime të vlerësimit për klientët e listuar nëse vlerësimi ka efekt material në PF.

Prandaj, para pranimit të angazhimit, firma e auditimit duhet të konsideroj ndikimin e transaksionit, nëse besojnë se është material, ata duhet ta refuzojnë angazhimin.

#### Detyra 4

Loni ShA është një grup i shumëllojshëm që është i përfshirë në aktivitete të ndryshme. Pasqyrat financiare draft për vitin që përfundoi me 31 mars 2017 paraqiten më poshtë:

<b>Ekstrakt i pasqyrave financiare</b>	<b>2017 draft €milion</b>	<b>2016 (të audituara) €milion</b>
Të hyrat	25.5	23.4
Fitimi para tatimit	2.6	2.5
Pasuri neto	24.8	22.7

Ju jeni menaxheri i auditimit përgjegjës për auditimin e vitit që përfundon me 31 mars 2017. Sapo keni vizituar vendndodhjen e klientit dhe jeni duke rishikuar punën që është kryer deri me sot. Seniori i auditimit ju ka lënë shënimet në vijim për tu konsideruar nga ju:

(a) Loni ka blerë një pronë në prill të vitit 2016 me një kosto €2.2 milion. Prona nuk ishte në gjendje të mirë mirëpo Lonit i nevojiteshin hapësira për zyra shumë shpejtë, prandaj e kishte zhvendosur disa nga stafin administrativ në ato hapësira menjëherë. Në janar 2017, u bënë të gatshme dhe disa hapësira dhe kështu kompania rilokojë edhe stafin tjetër. Ishte marrë vendim për ta shitur atë pronë. Prandaj ishte vendosur të mos llogaritet ndonjë zhvlerësim për atë pronë për vitin që po auditohej. Mirëpo, ishte nevojitur një punë domethënëse riparuese para se shitja të përfundonte. Kjo punë kishte filluar në shkurt 2017. Kosto e punës ishte paraqitur si shpenzim i riparimit dhe mirëmbajtjes. Prona kishte një çmim të rezervuar në ankand prej €3.5 milion, ankandi është paraparë të ndodhë me 30 qershor 2017. Prona është klasifikuar si 'E mbajtur për shitje' në fund të vitit sipas *SNRF 5 Pasuritë joqarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera* në vlerë prej 3.5 milion dhe një fitim prej 1.3 milion është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe të hyrave tjera gjithëpërfshirëse. (9 pikë)

(b) Në janar 2017, Loni ka blerë 53% të aksioneve të GH ShA për €1.7 milion. Kompania është trajtuar në kontabilitet si investim në shoqëri (filial) dhe rezultatet nuk janë konsoliduar. Drejtori financiar i grupit i ka dhënë dy arsye për këtë trajtim. E para, aktivitetet e GH ShA janë shumë të ndryshme nga ato të pjesës tjetër të grupit, dhe e dyta, nuk është integruar ende sistemi financiar i GH me pjesën tjetër të grupit. (7 pikë)

(c) Me 12 mars 2017, ka ndodhur një eksplozim në një nga ndërtesat e Loni, duke shkatërruar një të katërtën e saj. Fatëmirësisht, eksplozimi kishte ndodhur natën dhe askush nuk ishte lënduar. Inxhinierët dhe vlerësuesit aktualisht janë duke e vlerësuar stabilitetin e ndërtesës dhe ende nuk është e qartë nëse ndërtesa do të mund të riparohet apo do të shembet në tërësi dhe të rindërtohet. Në ditët e fundit, është pranuar një lajmërim nga pronarët e ndërtesave në afërsi të cilët pretendojnë se struktura e ndërtesave të tyre është dëmtuar nga eksplozimi. Ata poashtu treguan se aktualisht janë duke vlerësuar dëmin dhe stabilitetin e ndërtesave përmes inxhinierëve dhe vlerësuesve. Këta pronarë kanë njoftuar zyrtarisht kompaninë Loni se nëse eksplozimi ka ndikuar negativisht në ndërtesat e tyre, ata do të kërkojnë dëmshpërbim 'të përshtatshëm dhe të arsyeshëm' nga Loni. Kompania e sigurimit të Loni është informuar për këtë ngjarje dhe janë duke refuzuar të komentojnë deri sa të jenë të qarta faktet dhe efektet e ngjarjes. (9 pikë)

## Kërkohet:

Lidhur me secilën nga çështjet e mësipërme, vlerësoni në mënyrë kritike çështjet që duhet të konsiderohen dhe dëshimitë e auditimit që ju prisni ti gjeni gjatë auditimit të pasqyrave financiare të Loni për vitin që përfundoi me 31 mars 2017.

[Total: 25 Pikë]

## Përgjigja

Çështjet që duhet të konsiderohen

- Materialiteti: qështja është materiale. Kosto e pronës së blerë është gati 8.9% e pasurive totale dhe fitimi i njohur është 50% i fitimit para tatimit.
- Rreziku i anomalive materiale ka të bëjë me vlerën bartëse të pasurive joqarkulluese dhe shpenzimeve/ të hyrave në pasqyrën e të ardhurave.
- Prona është klasifikuar gabimisht si 'e mbajtur për shitje'. SNRF 5 thekson se që një pasuri të klasifikohet i 'e mbajtur për shitje', ajo 'duhet të jetë e gatshme për shitje të menjëhershme në kushtet e tanishme'. Ashtu siç shihet, puna ende është duke vazhdua prandaj kjo pasuri nuk mund të klasifikohet si e mbajtur për shitje. Ajo duhet të riklasifikohet si pjesë e pasurive joqarkulluese.
- Prandaj fitimi prej €1.3 milion nuk është dashur të regjistrohet dhe pasuria është dashur të zhvlerësohet për atë vit.
- Do të ishte e papërshtatshme të paraqitet si shpenzim i riparimit dhe mirëmbajtjes sepse natyra e ketyre shpenzimeve është më shumë kapitale për nga natyra, sidomos duke konsideruar qëllimin për ta shitur pronën.

Dëshmitë e auditimit:

- Kontrata e blerjes ose fatura
- Dëshmi mbi pagesën e kryer (transfer bankar)
- Dëshmi të përgatitjes së ndërtesës për tu shfrytëzuar nga kompania
- Procesverbalët e takimit që autorizojnë blerjen dhe më pas edhe shitjen e ndërtesës.
- Faturat dhe dëshmitë tjera lidhur me shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes.

(b) Çështjet për konsiderim

Ky duket të jetë transaksion material që paraqet gati 6.9% të pasurive totale.

- Përveç nëse ka rrethana të pazakonta që nuk janë përmendur në rast, mbajtja e 53% të aksioneve do të thotë se kompania ka kontroll mbi GH, prandaj duhet të trajtohet si degë për konsolidim.
- Asnjëra nga arsyet e drejtorit financiar nuk është e vlefshme për moskonsolidim. E vetmja arsye për moskonsolidim do të ishte nëse kompania është blerë për tu rishitur dhe kontrolli do të konsiderohej si i përkohshëm.
- Sipas rrethanave, regjistrimet në kontabilitet duhet të korrigjohen dhe kompania duhet të konsolidohet me mëmën.

Dëshmitë e auditimit

- Dëshmi të blerjes dhe pagesës së aksioneve.
- Shënimet e takimeve të bordit në të cilat autorizohet mblerja e kompanisë.
- Dokumentet siç janë regjistri i aksioneve dhe hulumtimi në databazë për verifikimin e numrit të aksioneve të blera për të vërtetuar se blerësi është aksionarë shumicë.
- Letrat e punës që tregojnë trajtimin sipas metodës së ekutiteti dhe më pas sipas metodës së blerjes (llogaritja e zërit të mirë siç kërkohet me SNRF 10 dhe SNRF 13)



(c) Çështjet që duhet të konsiderohen

- Kjo ngjarje ka ndodhur para fundit të periudhës prandaj duhet të reflektohet në PF për vitin që po auditohet.
- Eksplodimi do të thotë se prona dhe pasuritë tjera duhet të rishikohen për dëmtim sipas SNK 36.
- Gjithashtu është krijuar një detyrim i mundshëm ndaj pronarëve tjerë që pretendojnë këtë. Kjo duhet të kuantifikohet dhe të shpaloset në PF edhe pse aktualisht ka shumë pasiguri prandaj shpalosja mund të mos kërkohet (SNK 37).
- Duhet të rishikohet kontrata me kompaninë e sigurimit për mundësinë e mbulimit të dëmit dhe trajtimit në kontabilitet.

Dëshmitë e auditimit

- Detajet e incidentit, raportet nga autoritetet siç janë policia, kompania e sigurimit, etj
- Raportet paraprake nga vlerësuesit dhe inxhinierët
- Të gjitha korrespondencat me kompaninë e sigurimeve përfshirë polisën e sigurimit dhe dëshmi nëse është paguar ndonjë shumë deri në këtë datë.
- Lajmërimin nga pronarët e bizneseve tjera dhe kopjet e çfardo korrespondence me ata.
- Procesverbalet e takimeve të bordit në të cilat është diskutuar çështja. Në veçanti, shkaku i incidentit dhe mënyrat se si mund të parandalohet në të ardhmen.